LIGJ
Nr.8409, datë 25.9.1998

PËR RIPRODHUESIT RACË-PASTËR DHE TUFAT RACORE NË BLEGTORI

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është:

1. mbështetja e veprimtarisë së përmirësimit racor të kafshëve bujqësore që mbarështohen në territorin e Republikës së Shqipërisë;
2. mbështetja e ngritjes dhe e funksionimit të strukturave të përmirësimit racor të kafshëve bujqësore;
3. disiplinimi i funksionimit të hallkave të përmirësimit racor të kafshëve bujqësore.

Neni 2
Përkufizimet

Në këtë ligj termat e përdorur kanë këtë kuptim:

1. "Kafshë - pastër" quhen kafshët bujqësore, të vendit ose të importuara, që nuk bartin formacion gjenetik të racave të tjera, për jo më pak se dy brezni të paraardhësve të njohur.
2. "Riprodhues racë - pastër" quhen kafshët, paraardhësit e breznive të para dhe të dyta të të cilëve janë të regjistruar në një libër gjenealogjik të së njëjtës racë. Vetë këta individë plotësojnë kushtet për t'u regjistruar në një libër gjenealogjik.
3. "Material biologjik" quhen sperma, ovulat dhe embrionet.
4. "Libër gjenealogjik" quhet libri, regjistri, skedari apo suporti informatik ku regjistrohen të dhënat e kafshëve.
5. "Tufë racore" quhet tufa e riprodhuesve racë - pastër të një race të caktuar, që mbarështrohen në një fermë.
6. "Qendrat racore" quhen njësitë e specializuara në kuadrin e programeve të përmirësimit gjenetik për prodhimin e riprodhuesve me vlera të larta racore.
7. "Identifikim" quhet matrikullimi i kafshëve dhe regjistrimi i prejardhjes.
8. "Organizëm" quhen institucionet, organizatat shtetërore ose private që ngarkohen me organizimin dhe zbatimin e punës racore.
9. "Shoqatë" quhen organizatat e fermerëve, të njohura sipas ligjit, që përfshihen në hallkat e përmirësimit racor të kafshëve bujqësore.
10. "KQPR" - Komisioni Qendror i Përmirësimit Racor.

KREU I
RIPRODHUESIT

Neni 3

Riprodhuesit meshkuj të specieve të gjedhit, buajve, derrave, dhënve, dhive dhe të kuajve duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për t'u futur në riprodhim:

a) për ndërzim natyror: të jenë të regjistruar në librin gjenealogjik. Për specien e derrit të jenë të regjistruar në librin e hibrideve;

b) për inseminimin artificial: të jenë të regjistruar në librin gjenealogjik, në librin anagrafik ose në regjistrin e derrave hibridë dhe të kenë kaluar pozitivisht vlerësimin gjenetik, sipas kritereve të miratuara nga Komisioni Qendror i Përmirësimit Racor (KQPR).

Neni 4

Riprodhues derra hibridë janë kafshët e species së derrit që:
1. rrjedhin nga një kryqëzim i planifikuar ndërmjet:
a) derrave riprodhues racë - pastër, që u përkasin racave ose linjave të ndryshme;
b) kafshëve që rezultojnë nga një kryqëzim racash ose linjash të ndryshme;
c) kafshëve racë - pastër që rrjedhin sipas pikës 1.a dhe 1.b;
2. janë regjistruar në një libër gjenealogjik.

Neni 5

Riprodhuesit femra të specieve të gjedhit, buajve, derrave, dhenve, dhive dhe të kuajve duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
a) Të jenë të regjistruara në një libër gjenealogjik.
b) Të jenë në kontroll prodhimtarie, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Neni 6

Tufë racore quhet tërësia e riprodhuesve femra e meshkuj të një ferme, të cilët janë nën kontroll për prodhimtarinë dhe përfshihen në programet e përmirësimit gjenetik.
Miratimi i tufës racore bëhet nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, në bazë të propozimit të bërë nga zyra qendrore e librit gjenealogjik.

KREU II
ADMINISTRIMI

Neni 7

1. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit ngarkon organizmat dhe/ ose shoqatat e fermerëve, të njohura si person juridik, për mbajtjen e librave gjenealogjikë, regjistrave anagrafikë dhe regjistrave të derrave hibridë.
2. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit mbështet mbajtjen e rregullt të librit gjenealogjik, të regjistrave anagrafikë dhe të regjistrave të derrave hibridë, përfshi dhe kryerjen e kontrolleve të prodhimtarisë e të vlerësimit gjenetik.
Kriteret e përgjithshme teknike dhe të kontrollit përcaktohen me akte nënligjore.

KREU III
ORGANET E KONTROLLIT

Neni 8

Organet shtetërore të kontrollit përcaktohen në ligjin nr.7627, datë 21.10.1992 "Për shërbimin zooteknik", si dhe në rregulloren përkatëse.
Detyrat dhe funksionimi i inspektoratit të punës racore në blegtori përcaktohen me akte nënligjore.

KREU IV
LIBRI GJENEALOGJIIK

Neni 9

1. Libri gjenealogjik jep inforrmacion për seleksionimin e përmirësimit racor. Ai ka si qëllim kryesor përcaktimin e vlerës gjenetike dhe ekonomike të kafshëve.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit ngarkon një organizëm ose shoqatë fermerësh, të njohur si person juridik, për të mbajtur librin gjenealogjik.

3. Në librin gjenealogjik regjistrohen kafshët riprodhuese racë - pastër të një racë të caktuar, si dhe të dhënat e paraardhësve të tyre.

4. Në librin gjenealogjik përfshihen:

a) regjistrimi anagrafik, i cili mbahet nga një organizëm ose shoqatë fermerësh, e njohur si person juridik. Në këtë libër regjistrohen kafshët riprodhuese të një racë të caktuar me të dhënat e paraardhësve të tyre;

b) regjistri gjenealogjik i riprodhuesve meshkuj të gjedhit, buallit, dhënëve, dhive dhe kuajve;

c) regjistri gjenealogjik i riprodhuesve femra të gjedhit, buallit, dhenve, dhive dhe kuajve;

d) regjistri i derrave hibridë mbahet nga ferma ose shoqata fermerësh; në të regjistrohen hibridët riprodhuese, me të dhënat e paraardhësve të tyre.

5. Libri gjenealogjik mbahet dhe në nivel lokal.

6. Për të koordinuar veprimtarinë e zyrave lokale të librit gjenealogjik, për mbështetjen e programeve kombëtare të përmirësimit racor, për përpunimin e të dhënave statistikore, ngrihet me urdhër të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit "Zyra Qendrore e Librit Gjenealogjik".

7. Mënyra e funksionimit të librit gjenealogjik përcaktohet me akte nënligjore.

8. Kafshët që regjistrohen në libër duhet të jenë të matrikulluara, sipas rregullores përkatëse.

KREU V
QENDRAT RACORE

Neni 10

Qendrat racore miratohen nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, në bazë të propozimit të KQPR-së.

Funksionimi i qendrave racore përcaktohet me rregullore të veçantë.

Neni 11

Shfrytëzimi i riprodhuesve të prodhuar në qendrën racore për prodhim material biologjik mund të bëhet nga vetë qendra racore ose nga qendra të tjera të specializuara për këtë qëllim dhe të miratuara nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Neni 12

Shpërndarja e materialit biologjik bëhet nga organizma, shoqata ose persona fizikë e juridikë të licencuar, sipas kritereve të rregullores së riprodhimit.

Autorizimi për ushtrimin e kësaj veprimtarie lëshohet nga zyra qendrore e librit gjenealogjik.

Neni 13

Përdorimi i riprodhuesve ose i materialit biologjik bëhet nga persona fizikë ose juridikë, të pajisur me dëshmi aftësie nga një organizëm, shoqatë, person fizik ose juridik, të autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Neni 14

Shfrytëzimi i riprodhuesve meshkuj, të cilët rrjedhin nga tufa racore, për ndërzim natyror bëhet nga persona fizikë ose juridikë, të pajisur me dëshmi aftësie nga një organizëm, shoqatë, person fizik ose juridik, të autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për lëshimin e kësaj dëshmie. Autorizimi për ushtrimin e kësaj veprimtarie lëshohet nga zyra lokale e librit gjenealogjik.

KREU VI
IMPORTIMI DHE EKSPORTIMI

Neni 15

a) Importimi në Republikën e Shqipërisë i riprodhuesve meshkuj, në formën e kafshëve të gjalla, i materialit biologjik bëhet me miratim të Zyrës Qendrore të Librit Gjenealogjik, sipas kritereve të miratuara nga KQPR-ja.

b) Importimi i riprodhuesve, meshkuj e femra, të racave të reja bëhet pas miratimit nga KQPR-ja.

c) Eksportimi i riprodhuesve meshkuj, në formën e kafshëve të gjalla, material biologjik bëhet me miratimin e KQPR-së.

d) Eksportimi i riprodhuesve, meshkuj e femra, të racave autoktone bëhet pas miratimit nga KQPR-ja, sipas kritereve të përcaktuara prej këtij komisioni.

KREU VII
KOMISIONI QENDROR I PËRMIRËSIMIT RACOR

Neni 16

Pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit ngrihet dhe funksionon Komisioni Qendror i Përmirësimit Racor (KQPR). Ky komision drejtohet nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit ose i deleguari i tij. KQPR-ja punon në bazë të statutit dhe rregullores përkatëse që miratohet nga ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

Neni 17

Detyrat e KQPR-së janë:

1. Propozon ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit në fushën e përmirësimit racor të kafshëve bujqësore.
2. Cakton kriteret e funksionimit të librit gjenealogjik.
3. Cakton kriteret dhe harton rregulloret për shpalljen e tufave dhe të qendrave racore.
4. Cakton kriteret që duhet të plotësojnë riprodhuesit racë - pastër, meshkuj dhe femra, të gjedheve, të të leshtave, të të dhirtave, derrave e njëthundrakëve për t'u regjistruar në librin gjenealogjik.
5. Ateston racat që krijohen në vend dhe harton programet e ruajtjes dhe të zhvillimit të racave lokale.
6. Miraton metodat e vlerësimit gjenetik të riprodhuesve racë - pastër, të materialit biologjik, ovulave ose embrioneve.

KREU VIII
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE, SANKSIONET DHE PROCEDURAT

Neni 18

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

1. Kur inseminimi artificial dhe natyror i kafshëve bëhet me material biologjik dhe riproduktor të pamiratuar.
2. Kur kafshët regjistrohen në librin gjenealogjik ose anagrafik në kundërshtim me kriteret përkatëse.
3. Kur shfrytëzimi i riprodhuesve për prodhim material biologjik nuk bëhet nga strukturat përkatëse, të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji.
4. Kur shpërndahet material biologjik në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji.
5. Kur shfrytëzimi i riprodhuesve meshkuj, të cilët rrjedhin nga tufa racore për ndërzim natyror, nuk bëhet nga personat fizikë ose juridikë sipas kritereve të përcaktuara në nenin 14 të këtij

ligji.

6. Kur importimi dhe eksportimi në Republikën e Shqipërisë i riprodhuesve meshkuj, në formën e kafshëve të gjalla dhe të materialit biologjik bëhen në kundërshtim me kriteret e miratuara.

Neni 19

Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 18 të këtij ligji, nga organet e kontrollit vendosen gjobat si më poshtë:

1. Për shkeljet e parashikuara në nenin 18, pikat 1 dhe 6 gjobë prej 30-50 mijë lekësh. Në rast përsëritjeje me heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit për një periudhë 6-mujore.

2. Për shkeljet e parashikuara në nenin 18, pikat 2, 3, 4 dhe 5 gjobë prej 50-100 mijë lekësh.

Neni 20

1. Kanë të drejtë të vendosin masa administrative organet shtetërore të kontrollit, të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji.

2. Kundër vendimit të dënimit të dhënë nga inspektori mund të bëhet ankim me shkrim, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes ose e njoftimit, te drejtuesi i organit lokal të kontrollit ose te drejtori i organit të kontrollit në ministrinë përkatëse.

3. Mënyra e ankimit dhe e ekzekutimit të masës administrative bëhet në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 21

Organet e kontrollit për zbatimin e detyrës së ngarkuar me ligj mbështeten nga organet e pushtetit lokal të rendit, policisë doganore dhe tatimore.

KREU IX
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 23

Çdo ligj ose dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji, shfuqizohet.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2228, datë 5.10.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani